

DHOMA E BIZNESIT TË DIASPORËS SHQIPTARE



NGA ARDIAN LEKAJ / CILI DO TË JETË “NORMALITETI I RI”?

Kryetari i Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare z.Ardian Lekaj në një shkrim për gazetën "Diaspora Shqiptare" flet për situatën post Covid, ndikimin në ekonomi dhe "normalitetin e ri". Ekonomistët janë ndarë në dy grupime kryesore. Një grup mendon se është momenti për të bërë shkurtime drastike për të riformatuar biznesin dhe në këtë mënyrë krijohet një perspektive e re. Ata mendojnë se kriza do të zgjasë dhe se mënyra e jetesës dhe të bërit biznes po ndryshon, prandaj dhe duhet reaguar sa më shpejt. Ndërsa grupimi tjetër mendon se duhet të bëhet ndërhyrje vetëm pasi situata të stabilizohet. Sipas tyre në rast se ndërhyhet tani do të shkaktohet një efekt i dyfishtë negativ dhe do të jetë shumë i dhembshëm".

PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI: >>>>



BANKA E SHQIPËRISË : PËRKEQËSIMI I SITUATËS EPIDEMIOLOGJIKE CËNON EKONOMINË

Përkeqësimi i gjendjes epidemiologjike në vend dhe masat e mundshme kufizuese mund të cenojnë përmirësimin e shënuar nga ekonomia gjatë sezonit veror. Përmasat e ndikimit të pandemisë në ekonomi do të varen shumë nga shkalla dhe kohëzgjatja e masave të mundshme për kufizimin e përhapjes së saj. Veç ndikimit të masave kufizuese, rreziqet për ekonominë burojnë edhe nga shkalla e dëmtimit të kapaciteteve prodhuese, dhe mundësia e një rikuperimi më të ngadaltë të kërkesës së brendshme dhe asaj të jashtme, si edhe nga lindja e vështirësive në mekanizmin e transmetimit të politikës monetare.

PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI: >>>>



GREQI/ PREJ 9 NËNTORIT DUHET TË KETË TESTIN E COVID-19 KUSHDO QË HYN NË KUFI

Krahas masave të tjera të vendosura në vend për shkak të shtimit të rasteve me koronavirus, Greqia ka marrë dhe një vendim për kufijtë. Prej të hënës, 9 nëntor, udhëtarët që mbërrijnë në Greqi nga jashtë, si përmes aeroportëve, porteve detare dhe kufijve tokësorë, duhet të paraqesin testin me përgjigje negative për Covid-19 tek autoritetet. ata që hyjnë në vend përmes tokës, detit ose ajrit, do të jenë të detyruar të kenë një test negativ Covid deri në 48 orë, ndërsa ata që dëshirojnë të hyjnë në vend përmes kufirit tokësor, duhet të tregojnë një test negativ Covid deri në 72 orë.

PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI: >>>>



JAVA NË LAJME:

SHBA/ REVISTA AMERIKANE: FLORIM BAJRAKTARI SIPËRMARRËSI “INTELIGJENT” SHQIPTAR



KANADAJA NDRYSHON RREGULLAT E UDHËTIMIT, JA MASAT E REJA QË NISIN MË 21 NËNTOR



KROACI/ DEPUTETJA SHQIPTARE KRYEN BETIMIN SI ANËTARE E AVOKATURËS SË SHTETIT



KURSI I KËMBIMIT

MONEDHA	BLERJE	SHITJE
USD	104.20	105.10
EUR	123.50	124.10
CHF	115. ²⁰	116.20
GBP	136.30	137.30
DKK	16. ²⁷	16.67